


An abstract artwork featuring a complex composition of overlapping geometric shapes and organic, flowing lines. The color palette includes deep reds, earthy browns, dark greys, and muted yellows. A prominent white line winds through the center, creating a sense of movement. In the bottom left corner, a small, stylized bird is depicted. The overall effect is one of dynamic tension and layered meaning.

Lina Ogaily

Fier, 2018

Lina Ogaily

Contemporary Nostalgia / Nostalgi Bashkëkohore

Personal Exhibition / Ekspozitë Personale
Fier, 2018

Organiser / Organizator

Bashkia Fier
Galeria e Artit Fier "Vilson Kilica"
Shoqata Antik

Curator / Kurator

Pandeli Lena

Implementation/ Realizues

Pandeli Lena
Elenica Paloli

Design / Dizajni

Omar Al-Ajroush

Printing

bena
print



Abstragim Figurativ i Memories

Shek. XXI e ka shënuar tashmë epokën e vet, e cila vjen me karakteristika që orientohen kah një vizion i ri. Ai qartësohet prej mentalitetit të një brezi të ri njerëzish, që jeton deri diku me kufizime të ndryshme social-ekonomike nga ata të një shekulli më parë. Pavarësisht nivelit zhvillimor, jetojmë në një kohë të re, ku arti e artisti janë pjesë e organizimeve të ndryshme gjeopolitike. Madje, ata, i ndjekin këto zhvillime hap pas hapi, edhe pse ende arti është një materie, që buron prej individit artist - e kjo është një e vërtetë e paprekshme - i cili kohës sonë i jep produkte nga krijimtaria e lidhur me “trillin” e memories sesa nga krijimi si imazh i lindur nga ngjarje të ndodhura drejtëpërdrejtë.

Kjo mënyrë arsyetimi i ndan artistët në dy grupe të mëdha, që kanë në gjirin e vet nëngrupe me natyra të shumta. Me një vëzhgim të detajuar mbi pikturat dhe formimin e artistes Lina Ogaily, shpeshherë e rokanisja vëzhgimin sëbashku me dyshimet e mija. Në një çast fatlum, kur zbulova nga Roland Barthes nocionet “studium-studim” dhe “punctum-detaj”, me të cilët i afrohej zbulimit të fenomenit fotografi, qartësova idenë se piktura e Lina Ogaily është një imazh i gjerë, i krijuar nga një artiste, që i përket grupit të “trillit” të memories ose imazhit të asaj gjurme të memories që është stampuar prej fuqisë së botës së saj të brendshme, që nuk ka lidhje me fotografimin emocional, por me ndjesitë emoconale të memorjes. E kjo bëhet edhe më e qartë kur artisja më zbulon introversionin e saj, që do të thotë se psiku i saj është shumë i kujdesshëm për të kontrolluar botën e jashtme me anë të frymëmarrjes dhe syve të brendshëm të mendjes. Ky psik ka krijuar figura arti me subjekte të caktuara dhe me forcën e alternuar të emocioneve që shkaktohen nga kujtesa, nga vendlindja, nga besimi, nga kultura dhe nga impresionet e shkaktuara prej njerëzve të saj.

Lina Ogaily është një artiste e lindur në Kuwajt, që banon në Britani dhe ekspozon e punon në Lindjen e Mesme dhe në Britani. Ajo dëshiron dhe ekspozon në Fier, në Shqipëri, në një vend të vogël të Ballkanit. Shumë “pse” mund të ngrihen rreth arsyeve pse në Fier? Dhe shumë pse do të merrnin përgjigje. Por një prej tyre e merr përgjigjen pas një meditimi përfundimtar, të thjeshtë e të sinqertë. Sa shumë artistë me kombësi përkatëse nga vende të largëta të Lindjes, nga vende të varfëra të Ballkanit dhe Europës Juglindore, kanë lënë vendin e tyre për arsye politike, sociale, ekonomike dhe janë vendosur në mjedise e vende të zhvilluara e të përparuara të Europës dhe më gjërë? Nga fundi i shek. XX e deri në vitet që jetojmë shohim se si grupe të mëdha njerëzish, e në mes tyre artistë, lëvizin në teritore që i pandehin aftësisht më të mirë dhe shpresëdhënës se vendlindjet. Artistë nga Shqipëria, Iraku, Irani, Turqia, Armenia, Serbija, Maqedonia, Bosnja, Kosova, Rumania e vende të tjera janë vendosur, shkolluar e formuar si artistë ekstrakomunitarë në mjedise arti me zhvillim të ndryshëm nga vendi i tyre. Sa shpesh marrim pjesë në forume e ekspozita të përbashkëta të këtyre artistëve dhe sa shumë zbulojmë në brendësi të artit të tyre ekzistencën e një fije të përbashkët, ku janë kujtesa, nostalgjia, femënia, kultura dhe mëmësia e tokës së origjinës, të cilët i njohim si fenomene universale? Sa bindshëm mendojmë se kulturat periferike, lindore apo të vogla kanë pasuruar dhe lëngëzuar kultura të vjetra dhe të mëdha?

Arti i Lina Ogaily është një shembull i plotë i pseve dhe i përgjigjes pse ajo vjen në Fier, edhe pse jeta e saj artistike bëhet në vende të zhvilluara.

Lina Ogaily kërkon të ndajë me një publik të ri periferik, por të lashtë të Europës, konceptet e saj figurative mbi nostalgjitë dhe kujtimet. Ajo dëshiron nën emocion të bëjë publike figurat e shpirtit të saj të brendshëm, të cilat shtynë të dalin jashtë përmes një konteksti të caktuar parimesh mbi artin modern. Lina Ogaily kërkon të qendrojë përball publikut shqiptar, për të treguar historinë e formimit të saj si artiste irakiane në botën britanike, edhe pse jo, rezistencën e vet ndaj transformimeve të pashmangëshme. Kërkon të shpreh përpjekjet maksimale për të gjetur mënyrën e vet të krijimit në botën e gjerë dhe të ashpër të artit në arenën ndërkombëtare. Ajo kërkon të tregojë vendin që zë në botën e madhe të artit të shek. XXI, pasi zgjedhja nuk ishte krijimtaria didaktike e pasqyrimin të peizazhit natyror, as e figurës inaktive njerëzore që pozon, as e sipërfaqeve me ngjyra klasike, që referojnë emocione individuale, sepse zgjedhja e saj është të gdhendë gjurmë të abstragimit figurativ të memories jetësore.

Lina Ogaily zgjedhi një rrugë konceptuale figurative moderne, që u ndërtua prej meditimeve të që nga koha e hershme e femënisë; prej gjurmëve të përshtypjeve të adoleshencës së një gjimnazisteje në zbulim të kulturës së pasur dhe të mrekullueshme arabe dhe asaj të thellë të Lindjes së Mesme; prej nxitjeve të echo-ve kulturore, arkitektonike dhe artistike nga vendlindja dhe prej jehonave prindërore. Lina Ogaily memorizoi atmosferën irakiane, hoqi dorë nga pasqyrimi i drejtëpërdrejtë i saj si një imazh i zakonshëm dhe i përditshëm. Gjatë edukimit me programe të shkollave të larta të artit në Britani, artistja i dha krijimit të figurave koncepte domethënëse. Në këtë hapësirë studimore ajo u njoh me historinë e artit botëror dhe të kombësisë së saj arabe të Lindjes dhe kuptoi se shëmbëlltyrat kuptimplote e të vlera shekullore ndikuan në formimin e saj intelektual. Ajo në përballje me krijimtari të shumëllojta bashkëkohore gjeti rrugën e saj figurative, e cila ka pamjen e një produkti modern, me vizion të ri, që ka si nënshtresa ndjesinw e kaligrafisë, linjën, formën dhe ngjyrat e artit të kultivuar të botës së atdheut dhe Lindjes mahnitëse.

Kjo përvojë figurative, ky art meditativ, ky shtjellim krijues e sjell Lina Ogaily drejt Fierit, e cila është e veshur me ngazëllim të brendshëm shpirtëror, pasi do të këtë mundësi të shpalosë edhe një herë edhe shumë shumë herë nostalgjitë e saj në formën e veprës së artit modern.

Pikturat e Lina Ogaily është, siç edhe ajo pohon, “dialogu vetjak me çdo pjesë të artit për të krijuar një lidhje ose çlidhje me veten”. Në mendimin tim pikturat e saj janë bashkëjetesa dhe kombinimi i kulturës së Lindjes së Mesme apo asaj arabe, dhe pse mos, edhe frymës muslimane, me individualitetin psikik të artistes grua dhe krijimit laboratorik të stilit të saj. Pikturat janë një gjenerim i ri e në zhvillim i një kulture plot shtresa që veçanërisht i përket Irakut, i cili themelet e trashëgimisë kulturore i ka në kohën e Babilonisë dhe Mesopotamisë së Lashtë, ku arti i tyre arriti pika kulmore të njëjta me Egjiptin e Lashtë. Invazionet dhe pushtimet e egra mongole të shekujve XII dhe XIII shkatruan artin dhe kulturën tradicionale, të cilat u ringritën në shek. XVI, kur Iraku u bë një nga vendet më të njohura për miniaturat e famëshme, si dhe në shek. XVII, nën ndikimin Iranit, u bë një nga qendrat e ndriçuara të kaligrafisë, letërsisë, poezisë dhe arteve. Në shek. XX, rifreskohen kultura dhe tradita e artit, kombinohen traditat e trashëguara me traditat e reja, duke i dhënë shkas lindjes së artistëve modern të Lindjes së Mesme, të cilët e rritën artin e tyre përmes vizioneve bashkëkohore, duke përqafuar lëvizjet moderne. Nga kjo situatë njihen sot dhe kanë emër ndërkombëtarë artistë të shquar të saj si Jawad Saleem (1919-1961), Ismail Fatah Al Turk (1934/38-2004), Dia Azzawi (1939).

Ata janë iniciatorë të grupit “Vizion i Ri”. Lina Ogaily është mbështetur mbi artin dhe përvojat e tyre, gjë të cilën e përmend në CV-në e saj, me shumë respekt. Ajo, për të zhvilluar fizionominë abstraguese e moderne të krijimit, zbuloi nënlëkurën e artit, poezisë dhe letërsisë së Irakut. Ajo përqafoi qëllimin e mjeshtrove të lartëpërmendur natarë apo mendjehollë të shek. XX, që ishte formimi i një gjuhë unike të artit në Irak, e cila të ndërtohej mbi artin e madh të civilizimeve të lashta të Sumerëve, Babilonasve, Asirive, Mesopotamëve dhe të ndërthurej me artin e europianëve të shek. XX: Picasso, Klee, Calder, Matisse, Kandinsky etj. Lina Ogaily i'u përshtat qëllimit të mjeshtrove të Irakut dhe arti i saj është vazhdimësi e tyre.

Piktura e Lina Ogaily ka disa cilësi figurative, por kryesisht i përket abstraktes, gjeometrikes dhe ekspresives. Ajo është dydimensionale. Subjekti i abstraguar fillon nga një pikë në qendër dhe hapet organikisht në të gjithë sipërfaqen, duke lënë në shumë raste sfondin në formën e një kornize dhe në disa të tjera një sfond të shpërndarë. Ngjyrat, në disa piktura janë shumë të forta, ndjesore, të nxehta e goditëse. E gjelbërta, bluja, e kuqja, e verdha, e zeza dhe e bardha duket se bisedojnë “ashpër”. Lina Ogaily i njeh mirë ngjyrat dhe i ka përdorur si një formaliste emocionale, për të zbuluar qendresën e tyre mbi sipërfaqe dydimensionale, por edhe si shprehje e gjendjes së saj psikike në çastë të caktuara. Tonalitetet e njollave bardh e zi, ajo i përdor thekshëm, për të informuar mbi kontrastin, si në një fushë shahu. Mbase për të treguar rreth kontraditës, dyshimit, lojës, betejës, rivalitetit, që introverti zhvillon me ekstrovertin dhe e kundërta. Ajo luan me këtë fushë me të gjitha formatet dhe përmasat, që janë të çlirta në shumëllojshmërinë e tonaliteteve që harmonizojnë shkallën e fortësisë apo butësisë së njollave të ngjyrave. Ritmi i formave në sipërfaqen e pikturës herë shtrihet horizontal, e herë ngrihet vertikal, por edhe godet në forma amplitudash të rregullta, që të kujtojnë kuineformat sumeriane, gdhendur mbi sipërfaqe balte. Stili i vizatimit i përket një linje që shtrohet herë pastër drejt apo harkuar, herë është ndërprerësë dhe me zigzake. Në çdo rast krijon figurën e përgjithëshme mëmë, në të cilën brendashkruhen figura të vogla gjeometrike. Lina Ogaily arrin të krijojë me ngjyrat dy lloj sipërfaqesh si atë pastoze e të grimcuar, ashtu dhe të sheshtë e të lëmuar dhe, kjo e fundit i bën shpesh herë pikturat të marrin karakterin e një punimi dizajni. Gjithashtu piktura e saj herë lexohet sepse është tregimtare si piktura ‘Family portrait’, 2017 dhe herë abstragohet deri në qelizë si ‘Grandmother’, 2018.

Temat në pikturën e Lina Ogaily lidhen ngushtësisht me abstragimin shprehës të emocioneve, akteve dhe pamje njerëzore. Titujt e kryejnë këtë informim në mënyrë domethënëse. Subjektet në pikturë janë fytyrat njerëzore, gjestet dhe pozicionet e trupave të tyre, gratë e veshura dhe të mbuluara me burka, zogjtë; zogu dhe njeriu, që trajtohen në cikle; jetimët, bashkëshortët, shoqëria, familjarët, kohët dhe emocionet si: soditja, nostalgjia, ekso-det, pritja e tj. Krijimtaria e Lina Ogaily duket si një “déjà vu” e gjerë formash të shumëllojshme mbi njeriun, ku dominon linja elegante, e cila përmes shkathtësisë dhe aftësisë së artistes duket se përsëritet e përsëritet për të mos ndalur arkurr. Këtë e justifikon vet artistja kur mendon se: “Gjatë udhëtimit të saj kreativ dhe imagjinar ajo zbulon sesi reflektojnë fytyrat e njerëzve mbi pikturat e saj dhe se ky është shpërblimi më i madh që ajo do të dëshironte, ndërsa mendimet dhe ndjenjat që ato shprehin i japin asaj arsyen që të vazhdojë të pikturojë”.

**Suzana Varvarica Kuka-Studiuse arti
Tiranë, gusht 2018**

Figurative Abstraction of Memory

The 21st century has now made its mark, and this epoch comes with many orientations towards a new vision. It emanates from the mentality of a new generation of people, living through some rather different social and economical constraints, from those of a century ago. In spite of the progress and advancements, we live in a new time, where art and the artist, are part of the many geo-political developments. In fact, they follow these developments closely, even though art remains a substance derived from an individual artist, who shares with our time, products of personal creativity. Creativity that doesn't develop from an image born out of direct events, but rather creativity that is born out of the “thrill” of memory.

This method of argumentation, divides artists into two major groups, within which reside subgroups of many different natures. During an in-depth study of artist Lina Ogaily's paintings and her background, I often found myself wondering my gaze as well as my doubts. It was only in that lucky moment, when I discovered Roland Barthes's notions of “studium-study” and “punctum-detail”, towards the discovery of the photographic phenomenon, that I clarified my idea that Lina Ogaily's painting is a vast image, created by an artist that belongs to the “thrill of memory” group, in other words, the image as a trace of memory, indented by the force of her inner world. An inner world that is not really concerned with emotional photographing, but rather, with the moving sensations of memory. This becomes even clearer, when the artist is revealed to me as an introvert, whose psyche carefully controls the outer world through the inner breathing and eyes of the mind. This psyche has created works of art and subjects inspired by the alternating force of emotions caused by her memory, her birthplace, faith, culture and the impact of people.

Lina Ogaily is an artist, born in Kuwait, living in Britain and exhibiting and working in the Middle East and in UK. Her next destination is a small city in the Balkans, Fier, Albania. Many questions could arise, many “why” in Fier questions. All these “why-s” would eventually get an answer. One of them is answered after a final simple and sincere mediation. How many artists originating from the East or from poor countries in the Balkans and Eastern Europe have left their birthplace for political, social or economical reasons, to find themselves in developed Europe and beyond? Since the end of 20th century until present day, we find many large groups of people, as well as artists, migrating to territories they find more fit and optimistic. Artists from Albania, Iraq, Iran, Turkey, Armenia, Serbia, Macedonia, Bosnia, Kosovo, Rumania etc, have moved and are educated as expat artists in artistic environments that differ from their countries of origin. How often are we part of these artists' group exhibits or forums, and how much are we able to discover within their art about the existence of a common thread linking their memories, nostalgia, childhood, culture and motherhood of their lands of origin, which we all understand to be universal perceptions? And are we able to recognize how much these now smaller or sometimes peripheral or Eastern cultures have influenced and enriched ancient cultures and great civilizations. Lina Ogaily's art gives a comprehensive answer to all these questions like why she chose to exhibit in Fier as well as why her artistic life takes place in developed countries. Lina Ogaily wants to share her visual concepts about nostalgia and memory, with a new peripheral but also ancient European public. Through and through she wants to make public, the shapes of her inner soul which unfold through a context of modern art values. Lina Ogaily presents her work to the Albanian public, so she can tell the history of her training as an Iraqi artist in the British art world, as well as her resistance towards transformations

we can't avoid.

She wants to show her greatest efforts at finding her own creative expression in the vast and bumpy world of art in the international arena. She wants to show her place in the international art scene of the 21st century and her choice is not a didactic portrayal of the natural habitats, nor is it the inactive posing of the human figure, or the classically painted surfaces referring to individual emotions. She chooses to carve these deep marks and trace the figurative abstraction of memory. Lina Ogaily chose a modern figurative conceptual way, which is built based on her meditations since early childhood; her perceptions as an adolescent trying to discover the magnificently rich Arab and Middle Eastern culture; as well as the stimuli coming from cultural, architectonic and artistic echoes and parental resonance. Lina Ogaily memorized the Iraqi atmosphere and abandoned its direct representation as a common ordinary image. During her education in art academies in Britain, the artist attached meaningful concepts to her figurative productions. During this learning space, she was acquainted with the history of art worldwide as well as her Middle Eastern nationality and she came to know that this meaningful centurial imagery had affected her intellectual upbringing. Faced with many different contemporary practices, she found her own figurative way, which manifests a modern product, with a new vision that is layered with, lines, forms, hues and an utmost feeling of calligraphy, all in all cultivated from the art of the mesmerizing East.

This visual experience, this meditative art form and this creative discord brings Lina Ogaily to Fier, where she will present one more time her nostalgia in the form of modern art.

Lina Ogaily's painting is as she herself admits, "the personal dialogue with every element of art in order to do or undo a relationship with myself". It is my opinion that her paintings demonstrate the communion and combination of Middle Eastern and Arab culture as well as Islamic nature with the woman artist's psyche and the laboratorial creative process in her style. Paintings are a new and developing generation of a multi-layered culture that is especially true to Iraq, whose roots of cultural legacy reside in the times of Babylon and Ancient Mesopotamia. The artists of the time reached the same heights as Ancient Egyptians.

Invasions and angry conquests by the Mongols in the 12th and 13th centuries, destroyed the traditional art and culture, which were risen again in the 16th century, when Iraqis became one of the most well-known countries for their famous miniatures. Again in the 17th century, influenced by Iran, it became one of the most prominent centers of calligraphy, literature, poetry and art. In the 20th century, culture and tradition of the arts gets replenished, inherited traditions combine with new ones, giving birth to the modern artists of the Middle East, who practiced their art through contemporary visions and embracing the modern movements. Artists from this time, like Jawad Saleem (1919-1961), Ismail Fatah Al Turk (1934/38-2004), Dia Azzawi (1939) are initiators of the group "New Vision". Lina Ogaily is clearly influenced by their art and experience, as she also states in her CV, with much honor and respect. In order to develop the abstracted and modern physiognomy of creation, she discovered the inner layers of art, poetry and literature of Iraq. She embraced the goals of the brilliant masters of the 20th century mentioned above, who formed a unique language of art in Iraq, which came from ancient civilizations of Sumerians, Babylonians, Assyrian, and Mesopotamian as well as intertwined with art of Europeans of the 20th century like: Picasso, Klee, Calder, Matisse, Kandinsky

etc. Lina Ogaily adapted to the goals of the Iraqi masters and her art is in their continuity.

Lina Ogaily's painting has many figurative values, but it mainly belongs to the abstract, geometric and the expressive. She is two-dimensional. The abstracted subject starts from a main point in the center and organically opens up throughout the whole surface, in many cases letting the background take the form of a frame. In some paintings, the hues are strong, sensitive, warm and striking. The greens, blues, yellows, blacks and whites seem to be having a "strong" discourse. Lina Ogaily knows colors very well and like an emotional formalist, she has used them to discover their endurance on the two-dimensional surface, but also as an expression of her own psychological state at the time the painting took place. The tonalities of the black and white marks are beautifully accented, informing us of the contrasts as if we're in a field of chess. Maybe she wants to tell us about the contradiction, the doubt, the game, the battle and rivalry between the introvert and extrovert and vice versa. She plays in this field with all shapes and sizes, which are liberated within the diversity of tonalities, thus harmonizing the strength and fragility of the paint. The rhythm of the shapes on the surface of the painting is at times laying horizontally and at other times raising vertically, but most importantly it strikes in constant amplitudes, which remind you of Sumerian cuneiforms, engraved on clay. The drawing style conforms to a single line that is at times straight at times arched and at other times interrupted and oscillating. At all times, it creates the universal motherly figure, in whose depths we find many geometric prints. Using color, Lina Ogaily achieves two types of surfaces; the impasto and grainy, as well as the smooth and polished surface, the latter giving her paintings a graphic look. Her painting can be read because it narrates like in "Family portrait", 2017 but it also abstracts to the core like in "Grandmother", 2018.

The themes in Lina Ogaily's painting are closely linked to the expressive abstraction of human emotions, actions and exteriors. The titles inform, in a very consequential way. The subjects in the paintings are human faces, gestures and physical stances, women dressed and covered in burqas, birds; man and bird, discussed in cycles; orphans, spouses, social circles, family, time and emotions like: contemplation, nostalgia, exodus, anticipation etc. Lina Ogaily's body of work seems like a vast "déjà vu" of diverse human shapes, where the elegant line is dominant and through the artist's agility and proficiency, it seems to go on and on and on without ever stopping. The artist testifies by saying that, "Seeing this journey of discovery on the faces of people as they reflect on my paintings is the greatest reward I could wish for, and the thoughts and feelings they take with them is the reason I continue to paint."

Suzana Varvarica Kuka - Art Researcher
Giada Kuka- English TRanslation
Tirana, August 2018



Nostalgia, 2013, Acrylic on Canvas, 150 x 100 cm



From Dusk Til Dawn, 2014, Acrylic on Canvas, 100 x 100 cm




The Bird Song, 2018, Acrylic on Canvas, 120 x 100 cm



The Wait, 2013, Acrylic on Canvas, 80 x 100 cm



Reminiscence, 2017, Acrylic Ink on Archival Paper, 41 x 31 cm



Mothers & Babies I, 2017, Acrylic Ink on Archival Paper, 41 x 31 cm



Mothers & Babies II, 2017, Acrylic Ink on Archival Paper, 41 x 31 cm



Angels on Blue, 2018, Acrylic Ink on Archival Paper, 41 x 31 cm



Descension, 2017, Acrylic Ink on Archival Paper, 41 x 31 cm



Self Portrait, 2017, Acrylic Ink on Archival Paper, 41 x 31 cm



Bird Song / Blue Miniature Series I & II, 2018, Acrylic Ink on Archival Paper, 18 x 13 cm



Bird Song / Metallic Miniature Series I & II, 2018, Acrylic Ink on Archival Paper, 21 x 15 cm

Lina Ogaily

www.linaogaily.com

Education

1996- BA Interior Architecture, Kingston University, Surrey
1993- BTECH Art and Design, Chelsea College of Art, London

Exhibitions

2018- London Arabia Art Show, London
2018- Fier Art Gallery, Albania
2018- Flux Exhibition, London
2017- Al Owais Foundation, Dubai
2017- New Artist Fair, Old Truman Brewery, London
2016- Private View Exhibition, London, SW15
2015- FN Design Gallery, Dubai
2015- Art Plus Gallery, Dubai
2015- Capsule Art, Dubai
2014- Al Tawasul, Emirates Fine Art Society, Sharjah
2014- Noun Al Neswa 3rd Edition, Marsam Mattar, Dubai
2013, 2011, 2010, 2009, 2008, 2007- Courtyard Gallery, Dubai
2012- Showcase Gallery, group show & auction, Dubai
2012- Ruwaq Gallery, Sharjah Gov. Department of Culture & Info, Sharjah
2012, 2010, 2008- 4 Walls Gallery, Dubai
2011- Arjun Art Gallery, Abu Dhabi
2011- Rotana Beach Hotel, Charity Art Show, Abu Dhabi
2010- Ghaf Gallery, Abu Dhabi
2010- Millenium Hotel, Charity Art Auction, Abu Dhabi
2010, 2009- Qibab Gallery, Abu Dhabi
2009- Gallery 76, DIAC, Dubai
2004, 2001- Private show , Dubai
1999- Private show, Abu Dhabi
1996- Kingston University, Surrey

Collections

- Barjeel Art Collection- Sheikh Sultan Sooud Al-Qassemi, Sharjah
- Mirabili Art Centre- Elisabetta Gucci, Florence
- Hussain Abbas Ali Harba Collection, Torino (Published: Longing for Eternity- One Century of Contemporary and Modern Iraqi Art)





Li Ogaily 2017